



**Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber Kosovo**

**RREGULLORE
PËR ZGJEDHJEN E ORGANeve TË OSK-SË**

Prishtinë, nëntor 2022

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 20, parografi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në rnbledhjen e datës 12.11.2022, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR ZGJEDHJEN E ORGANeve TË OSK-SË

PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë dhe përcaktojë të drejtat zgjedhore, procedurat, kushtet, kriteret, kompetencat dhe përgjegjësitë në procesin e zgjedhjeve të brendshme të organeve përfaqësuese të OSK-së.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo regullore zbatohet në procedurat e zgjedhjes së organeve përfaqësuese të OSK-së, si organe individuale apo kolegjiale.
2. Dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen për procedurat e zgjedhjes së organeve për të cilat procedurat e zgjedhjes janë të rregulluara me dispozita të veçanta të akteve të tjera normative të OSK-së.

Neni 3 Përkufizimet

1. Në kontekst të kësaj rregullore, termet dhe akronimet e përdorura kanë këto kuptime:
 - 1.1 **Libri i Votimit** - është formë e aprovuar nga KQZ-ja në të cilën shënohen sqarimet, plotwsimet dhe vërejtjet përkitazi me procesin zgjedhor nga anëtarët e KNJZ-së, vëzhguesit dhe votuesit;
 - 1.2 **Lista e Votuesve** - lista me të dhënat e anëtarit të OSK-së të cilët kanë të drejtë votimi për Kuvendin e OSK-së;

- 1.3 **KD** - Këshilli Drejtues
- 1.4 **KQZ** - Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve, organ i pavarur përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve;
- 1.5 **KNJZ** - Komisioni i Njësisë Zgjedhore përgjegjës për administrimin e procesit në njësi zgjedhore brenda rajonit përkatës;
- 1.6 **KQV** – Komisioni i Qendrës së Votimit;
- 1.7 **Njësi Zgjedhore** — nënkuption bazën deleguese të përfaqësirnit të anëtarëve në Kuvendin e OSK-së që themelohet në kuadër të rajonit;
- 1.8 **Organizatë e akredituar** - organizatë joqeveritare e cila përmes procedurës së përcaktuar me këtë rregullore zgjedhore akreditohet për ta vëzhguar procesin e zgjedhjeve në SK-së;
- 1.9 **OSK**– Oda e Stomatologëve të Kosovës;
- 1.10 **Procedurë qarkulluese** - éshtë votim nga distanca në mënyrë elektronike;
- 1.11 **QV** – Qendra e Votimit
- 1.12 **SKQZ**- Sekretariati i KQZ-së;
- 1.13 **Vëzhgues** - personi i certifikuar nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin Zgjedhor.

Neni 4 **Shpallja e zgjedhjeve**

1. Kuvendi i OSK-së cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e OSK-së.
2. Zgjedhjet për Kuvendin e OSK-së nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të mandatit të legjislaturës përkatëse.
3. Vendimi i Kuvendit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë (6) muaj dhe jo më vonë se 1 (një) muaj para datës së zgjedhjeve.
4. Kuvendi i OSK-së zgjedhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.
5. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në web faqen e OSK-së.

Neni 5 **Zgjedhjet e jashtëzakonshme**

Zgjedhjet e jashtëzakonshme do të mbahen dhe organizohen nga KQZ-ja sipas procedurës për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta që janë të parapara me këtë rregullore, në afat jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetë (40) ditë nga shpérndarja e Kuvendit.

PJESA II

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, SEKRETARIATI, NJËSITË ZGJEDHORE DHE KOMISIONET ZGJEDHORE

KREU I

PËRBËRJA, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË ORGANIZATIVE TË KQZ-SË

Neni 6

Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve

1. Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve, është organ i OSK-së me mandat 4 vjeçar dhe i pavarur. KQZ-ja siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me Statutin e OSK-së dhe kësaj rregullore.
2. KQZ është e vendosur në selinë e OSK-së.
3. KQZ ka vulën e saj autentike, përmbajtja, forma, dimensionet dhe mënyra e përdorimit të vulës përcaktohen me vendim të KQZ-së.
4. KQZ ka protokoll të veçant.

Neni 7

Përbërja dhe mandati i KQZ-së

1. KQZ përbëhet nga kryesuesi dhe 4 (katër) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i OSK-së me propozimin e Këshillit Drejtues.
2. Anëtarët e KQZ-së kanë mandat 4 (katër) vjeçar nga dita e zgjedhjes së tyre dhe deri në përfundimin e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve me mandat të ri. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së duhet të filloj 15 ditë (pesëmbëdhjetë) para skadimit të mandatit të anëtarëve ekzistues të zgjedhur të KQZ-së.
3. Deri në zgjedhjen e aëtarëve të rinj të KQZ-së, anëtarët e mandatit ekzistues do të ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjesitë e tyre.
4. Anëtarët e KQZ-së mund të zgjedhen vetëm për dy mandate dhe të njëjtë nuk mund të jenë kandidatë për anëtarë të organeve të OSK-së.
5. Anëtarët e zgjedhur të KQZ-së nuk mund të mbështesin me nënshkrim asnjë kandidat për anëtar të Kuvendit të OSK-së.

Neni 8 **Kompetencat e KQZ-së**

1. KQZ-ja në pajtim me këtë rregullore ka këto përgjegjësi:
 - 1.1 përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me Statutin e OSK-së dhe këtë rregullore;
 - 1.2 përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve të anëtarëve të organeve të OSK-së;
 - 1.3 përgatitjen dhe miratimin e planit të veprimit dhe përcaktimin e detyrave të veçanta;
 - 1.4 përcaktirnin e afateve kohore në ekzekutimin e planit të veprimit dhe monitorimin e zbatimit të tij;
 - 1.5 emërimin e KNJZ-ve;
 - 1.6 mbikëqyrjen e punës së KNJZ-ve dhe veprimeve përgatitore në procesin zgjedhor;
 - 1.7 miraton formën dhe dizajnin e fletë votimit;
 - 1.8 certifikimin e listës së votuesve;
 - 1.9 certifikimin e kandidatëve për organe të OSK-së;
 - 1.10 certifikimin e rezultatit zgjedhor dhe shqyrtimin e ankesave zgjedhore të parashtruara nga palët;
 - 1.11 trajnimin dhe sigurimin e materialit zgjedhor për KNJZ-të;
 - 1.12 përcaktimin e QV;
 - 1.13 nxjerr akte tjera dhe kryen edhe detyra të ndryshme në realizim të zgjedhjeve të organeve të OSK-së në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Jashtë procesit të rregullt zgjedhor mbledhjet e KQZ-së thirren me kërkesën e Kryetarit të OSK-së sipas nevojës konkrete për çështje nga fushëveprimi i kësaj rregullore.
3. Çështjet tjera të mbarëvajtjes së punës të KQZ-së rregullohen përshtatshmërisht me rregulloren për punën e organeve kolegiale të OSK-së.

Neni 9 **Kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KQZ-së**

1. Anëtarët e KQZ- së kanë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1. kujdesen për zbatimin e kësaj rregullore dhe akteve të tjera të nxjerra nga KQZ-ja;
 - 1.2. marrin pjesë në mbledhjet e KQZ-së dhe japidn propozimet e tyre lidhur me çështjet që trajtohen në mbledhjet e KQZ-së;
 - 1.3. kryejnë detyrat e përcaktuara nga KQZ-ja dhe ndërmarrin veprimet e përcaktuara sipas planit të miratuar të veprimit;

- 1.4. propozojnë plotësimin dhe ndryshimin e rendit të ditës;
 - 1.5. njoftojnë kryesuesin dhe arsyetojnë për mos pjesëmarrje në mbledhje;
 - 1.6. përbahet dhe deklarohet në rast se dyshon lidhur me ekzistimin e ndonjë rrethane të konfliktit të interesit dhe
 - 1.7. kryejnë veprime të tjera brenda fushëveprimit të KQZ-së.
2. Anëtari i KQZ-së është i obliguar që mungesën e tij në mbledhjen e ardhshme të thirrur të KQZ-se ta arsyetojë. Në rast të tri mungesave të paarsyeshme, anëtarit të KQZ së i përfundon mandati.

Neni 10 Kryesuesi i KQZ-së

1. Kryesuesi i KQZ-së ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1 Përfaqëson KQZ-në;
 - 1.2 Thërret mbledhjet e KQZ-së dhe propozon rendin e ditës;
 - 1.3 Kryeson mbledhjet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
 - 1.4 Kujdeset për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje, vendimeve, akteve të tjera të KQZ së dhe akteve normative të OSK-së brenda fushëveprimit të KQZ-së;
 - 1.5 Siguron transparencën e akteve që i nxjerr KQZ-ja;
 - 1.6 Nënshkruan vendimet dhe aktet tjera të miratuar nga KQZ-ja;
 - 1.7 Kryen dhe ndërmerr veprimet tjera të nevojshme për funksionalitetin e KQZ-së.
2. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga paragrafi 1, të njëjtat do të ushtrohen nga zëvendëskryesuesi i KQZ-së.

Neni 11 Zëvendëskryesuesi i KQZ-së

1. Zëvendëskryesuesi i KQZ-së zgjedhet nga radhët e anëtarëve të KQZ-se me propozim të kryesuesit te KQZ-së.
2. Zëvendëskryesuesi i KQZ së zgjedhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të KQZ-së.

Neni 12 Mbledhjet e KQZ-së

1. KQZ-ja mban mbledhjet e rregullta të paktën një herë në javë nga shpallja e zgjedhjeve të OSK-së. Jashtë procesit të shpallur zgjedhor mbledhjet thirren sipas nevojës konkrete në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të KQZ së.
2. Mbledhjet e rregullta i thërret Kryesuesi me propozim të rendit të ditës për mbledhjen e thirrur.
3. Rendi i ditës dhe materiali përcjellës i dërgohet anëtarëve të KQZ-së së bashku me ftesën për mbledhje.

4. Ftesa dhe materiali nga paragrafi 3 duhet t'u dërgohen anëtarëve të KQZ-së së paku 24 orë para mbledhjes së thirrur.
5. Në pamundësi të thirrjes së mbledhjes nga Kryesuesi, mbledhja e rregullt mund të thirret edhe nga Zëvendëskryesuesi.
6. Mbledhjet e jashtëzakonshme të KQZ-së mund të thirren me kërkesën e të paktën 3 (tre) anëtarëve të KQZ-së. Detyrimet lidhur me paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni nuk janë të zbatueshme me rastin e thirrjes së mbledhjes së jashtëzakonshme.
7. Për të gjitha mbledhjet e KQZ-së përpilohen procesverbalet të cilat po ashtu ruhen në arkivin e KQZ-së. Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur të KQZ së miratohen në mbledhjen e radhës.
8. Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëherë janë të zbatueshme dispozitat e Rregullores për procedurat e vendimmarjës të organeve të OSK-së.

Neni 13 **Procesverbalet e mbledhjes së KQZ-së**

1. Procesverbali i mbledhjes së KQZ-së përfshin:
 - 1.1 Datën dhe vandin e mbledhjes;
 - 1.2 Pjesëmarrësit që janë prezentë në mbledhje;
 - 1.3 Rendin e ditës të aprovuar nga KQZ-ja;
 - 1.4 Çështjet e diskutuara në mbledhje;
 - 1.5 Vendimet që janë marrë;
 - 1.6 Formën dhe rezultatin e votimeve.
2. Pas miratimit nga anëtarët e KQZ së, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

Neni 14 **Kuorumi dhe vendimmarrja**

1. KQZ-ja ka kuorum kur janë të pranishëm të paktën tre (3) anëtarë të KQZ-së.
2. Para çdo vendimi, Kryesuesi i mbledhjes duhet të konstatojë kuorumin e mbledhjes.
3. Vendimet e KQZ-së merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KQZ-së.
4. Në rastet kur numri i votave për dhe kundër janë të barabarta, vota e Kryesuesit të mbledhjes është vendimtare.
5. Në çdo pikë të rendit të ditës, Kryesuesi e hap diskutimin, e hedh në votim dhe konstaton përmbajtjen e vendimit dhe rezultatin e vendimit.
6. KQZ vendos për këto çështje:
 - 6.1 Miratimin e Rregullave Zgjedhore,
 - 6.2 Certifikimin e Listës së Votuesve;
 - 6.3 Certifikimin dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore;
 - 6.4 Vendimet lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me shpalljen e rezultateve.

7. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari i KQZ-së ka për obligim që të vetëdeklarohet dhe të tërhiqet nga procedura e votimit. Në rast të mosdeklarimit të anëtarit lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit, rrethana e tillë mund të denoncohet nga secili anëtar i KQZ-së. Në rast të denoncimit të tillë Kryesuesi i mbledhjes e nxjerr në votim denoncimin e arsyetuar. Në rast të vetëdeklarimit apo denoncimit të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari që konsiderohet se gjendet në rrethana të tilla, përjashtohet nga shqyrtimi dhe votimi i çështjes për të cilën duhet vendosur.

Neni 15
Votimi

1. Votimi në mbledhjet e KQZ-së është i hapur.
2. Forma e votimit bëhet përmes votës PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM.
3. Vendimet e KQZ-së së mund të merren edhe në procedurë qarkulluese. Procedura qarkulluese është procedurë e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me shkrim, pa qenë e nevojshme mbledhja e KQZ-së.

KREU II
SEKRETARIATI I KQZ-SË

Neni 16
Detyrat dhe përgjegjësitet e Sekretariatit të KQZ-së

1. Sekretariati i KQZ së është njësi administrative e KQZ-së që në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësive, ndihmon KQZ-në në zbatimin c proçesit zgjedhor në pajtim me këtë rregullore dhe akteve tjera normative të OSK-së.
2. Sekretariati i KQZ së ushtron këto funksione:
 - 2.1 Bën njoftimin e anëtarëve të KQZ-së për mbledhjet e thirrura në pajtim me këtë rregullore;
 - 2.2 Përgatit dhe dërgon materialin e nevojshëm;
 - 2.3 Merr pjesë në ekzekutimin e planit të veprimit të miratuar nga KQZ-ja;
 - 2.4 Kryen të gjitha veprimet që i besohen nga KQZ-ja lidhur me procesin zgjedhor;
 - 2.5 Ofron mbështetje logjistike për nevojat e mbarëvajtjes së proçesit zgjedhor;
 - 2.6 Koordinon shpërndarjen dhe mbledhjen e materialit zgjedhor në afatet e përcaktuara me Planin e Veprimit;
 - 2.7 Siguron mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve si dhe evidencën e pjesëmarres në mbledhje;
 - 2.8 Kryen punë tjera sipas nevojës.

3. Sekretariati i KQZ-së mund t'i propozojë KQZ-së çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet operacionale të procesit zgjedhor dhe të propozojë që çështjet e tilla të shqyrtohen në mbledhjen e KQZ-së.

Neni 17
Përbërja e Sekretariatit të KQZ-së

1. Sekretariati i KQZ-së përbëhet nga zyrtarët e Shërbimit Profesional të OSK-së.
2. Këshilli Drejtues cakton koordinatorin dhe përbërjen e Sekretariatit të KQZ-së.
3. Sekretariatit të KQZ-së sipas nevojës mund t'i caktohen anëtarë shtesë me miratimin e Kryetarit të OSK-së.
4. Sekretariati i KQZ-së është bartës i detyrave dhe përgjegjësive gjatë gjithë kohës sa zhvillohet procesi zgjedhor.
5. Dispozitat e paragrafit paraprak zbatohen përshtatshmërisht edhe gjatë organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për ndonjërin nga organet e OSK-së.

KREU III
NJËSITË ZGJEDHORE DHE KOMISIONET E NJËSIVE ZGJEDHORE

Neni 18
Njësitë Zgjedhore

1. Njësitë zgjedhore themelohen si më poshtë:
 - 1.1 **Njësia zgjedhore e Prishtinës:** Prishtinë, Fushë Kosovë, Podujevë, Lipjan, Obiliq, Gllogoc, Graçanicë.
 - 1.2 **Njësia zgjedhore e Prizrenit:** Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash, Mamushë.
 - 1.3 **Njësia zgjedhore e Pejës:** Pejë, Deçan, Klinë, Istog Junik.
 - 1.4 **Njësia zgjedhore e Gjakovës:** Gjakovë dhe Rahovec.
 - 1.5 **Njësia zgjedhore e Gjilanit:** Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Kllokot, Partesh, Ranilluk.
 - 1.6 **Njësia zgjedhore e Ferizajit:** Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpcë, Hani i Elezit.
 - 1.7 **Njësia zgjedhore e Mitrovicës:** Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok.
 - 1.8 **Njësia zgjedhore e Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës me Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale.**
2. KQZ-ja nxjerr vendim për të përcaktuar:
 - 2.1 Qendrat e votimit në Njësinë Zgjedhore;
 - 2.2 Numrin e anëtarëve, nga të cilët përbëhet Njësia Zgjedhore;

2.3 Numrin e anëtarëve të deleguar për Kuvendin e OSK-së.

3. Se në cilën Njësi Zgjedhore anëtari i Odës mund të kandidojë apo të votojë përcaktohet në bazë të vendbanimit të përhershëm të anëtarit të Odës apo Institucionin ku ushtron kujdesin shëndetësor të dëshmuara me dokumentacionin përkatës, të përfshira/evidentuara në databazën e OSK-së.

Neni 19
Komisioni i Njësisë Zgjedhore

1. Në çdo Njësi Zgjedhore të votimit themelohet KNJZ.
2. KNJZ ka tre (3) anëtarë: Kryesuesin e KNJZ-së, Komisionerin përfshira/identuara e listës identifikuese, të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve brenda njësisë zgjedhore.
3. KNJZ-të certifikohen me vendim të KQZ-së jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve.
4. KNJZ-të do të kenë mandat deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor nga KQZ-ja.
5. Anëtarët e KNJZ-së janë anëtarë me të drejtë vote në atë njësi. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, si refuzimi i marrjes së detyrës nga të gjithë anëtarët apo mospërgjigja për pranim të detyrës brenda 5 ditëve nga KQZ, KQZ mund të emërojë anëtarë të KNJZ-së edhe anëtarët të cilët nuk janë votues të asaj njësie zgjedhore.
6. Asnjë anëtar nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, ose të vazhdojë të shërbejë pasi që është caktuar, po që se është kandidat përfshira/identuara e listës identifikuese.
7. Asnjë anëtar nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, nëse është në konflikt interesit lidhje familjare me ndonjë nga kandidatët e njësisë zgjedhore ku është caktuar anëtar, të cilin detyrohet ta deklarojë para se të ushtrojë funksionin në KNJZ.
8. Asnjë anëtar nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KNJZ-së, nëse ka dhënë nënshkrim mbështetës përfshira/identuara e listës identifikuese.
9. KQZ mund të nxjerr akt të veçantë me të cilin mund të përcaktojë kompetenca dhe përgjegjësi shtesë përfshira/identuara e listës identifikuese.
10. KQZ cakton anëtarë rezervë përfshira/identuara e listës identifikuese.
11. Emërimi i një anëtarë të KNJZ-së i nënshtron betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes së KQZ-së të miratuar nga KQZ-ja, para fillimit të punës.

Neni 20
Kompetencat dhe përgjegjësitet e KNJZ-së

1. KNJZ-të kanë kompetencë dhe përgjegjësi për:
 - 1.1 mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në QV të njësisë zgjedhore;
 - 1.2 zbatimin e të gjitha masave të përcaktuara nga KQZ-ja për ta menaxhuar procesin e votimit;
 - 1.3 kujdesin ndaj materialit zgjedhor dhe përdorimin e tij sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja;
 - 1.4 shmangien dhe raportimin e parregullësive zgjedhore në rast të evidentimit të tyre;
 - 1.5 kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara nga KQZ-ja.
2. KQZ-ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të KNJZ-së nëse:
 - 2.1 nuk i kryen detyrat sipas rregullave të KQZ-së;
 - 2.2 vepron në mënyrë të anshme dhe joprofesionale;
 - 2.3 nuk merr pjesë në dy takime të njëpasnjëshme të KNJZ-së pa ndonjë arsyet bazuar;
 - 2.4 merr pjesë në përkrahje të kandidatëve për anëtarë të Kuvendit.

KREU IV
PLANI I VEPRIMIT DHE MJETET FINANCIARE

Neni 21
Plani i veprimit

1. Plani i Veprirnít është akt i miratuar i KQZ-së me të cilin bëhet konkretizimi i veprimeve dhe aktiviteteve të KQZ dhe KNJZ.
2. Plani i Veprimit do të përbajë:
 - 1.1 Procedurat e zgjedhjeve, njoftimin, publikimin dhe informimin;
 - 1.2 Veprimet që duhet ndërmarrë për sigurimin e Listës së Votuesve dhe veprimet në lidhje me verifikimin;
 - 1.3 Oraret për sigurimin e materialit të nevojshëm për veprimet përgatitore të procesit zgjedhor;
 - 1.4 Caktimin e kohës dhe afateve për caktimin e anëtarëve të KNJZ-ve dhe procedimit për certifikim nga KQZ-ja;
 - 1.5 Mënyrën dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e materialit zgjedhor;
 - 1.6 Të gjitha çëshjet operacionale mbi përgatitjen, menaxhimin dhe përfundimin e procesit zgjedhor.
3. Plani i Veprimit i miratuar nga KQZ-ja mund të ndryshohet apo të plotësohet nga KQZ-ja sipas nevojave që paraqiten gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor.

Neni 22
Mjetet financiare për organizimin e zgjedhjeve

1. OSK siguron mjetet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve, të destinuara për:
 - 1.1 Sigurimin e materialit zgjedhor dhe materialeve tjera shpenzuese;
 - 1.2 Pajisjet dhe mjetet e nevojshme teknike për organizimin e zgjedhjeve;
 - 1.3 Shpenzimet e rrugës, post-telekomunikacionit;
 - 1.4 Kompensimi për anëtarët e KQZ-së;
 - 1.5 Kompenzimin e Sekretariatit;
 - 1.6 Kompenzimi për anëtarët e KNJZ-së;
 - 1.7 Shpenzimet e informimit publik;
 - 1.8 Angazhim të personave tjerë për nevojat e procesit zgjedhor;
 - 1.9 Shpenzime të paparapara për organizimin e zgjedhjeve të miratuara nga Kryetari i OSK-së, sipas kërkesës së KQZ-së.
2. Anëtarët e KQZ-së dhe KNJZ-së kompenzohen për takimet e tyre barazvlershmë me mëditjet për komisionet e OSK-së.
3. Kompenzimi i anëtarëve të Sekretariatit përcaktohet nga Këshilli Drejtues me propozim të Kryetarit të OSK-së, për periudhën e procesit zgjedhor të Kuvendit të OSK-së.

PJESA III
PËRFAQËSIMI, KANDIDIMI DHE ZGJEDHJET PËR KUVEND

KREU I
MËNYRA E PËRFAQËSIMIT NË KUVEND

Neni 23
Përfaqësimi në Kuvendin e Odës

1. Kuvendi i Odës ka 55 anëtarë dhe reflekton përfaqësimin proporcional sipas nenit 18.
2. Njësia zgjedhore zgjedh një anëtar në Kuvendin e OSK-së sipas **çelsit përfaqësues**:
Numri i pergjithshëm i anëtarëve të OSK-së në raport me numrin e anëtarëve të Kuvendit dhe numri i fituar në përpjestim me numrin e anëtarëve të njësisë zgjedhore.
3. Mandati i anëtarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të organeve të Odës është 4 vite dhe vazhdon deri në rizgjedhjen dhe konstituimin e Kuvendit të ri të OSK-së.
4. Anëtarët e Kuvendit mund të rizgjedhen vetëm edhe një mandat tjetër.
5. Nëse zgjedhjet për anëtarë të Kuvendit ose për organet tjera të Odës nuk mbahen në kohën e duhur, anëtarët e zgjedhur (ekzistues), përkatësisht anëtarët e organeve të Odës, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, maksimumi një vit nga përfundimi i mandatit të tyre.

6. Nëse anëtari i Kuvendit të Odës e ndryshon adresën e vendbanimit të përherershëm apo të Institucionit ku ushtron kujdesin shëndetësor, mbetet deri në fund të mandatit si përfaqësues i njësisë zgjedhore në të cilën është zgjedhur.

Neni 24
Zgjedhja e anëtarëve të Kuvendit të OSK-së

Anëtarët e Kuvendit të OSK-së zgjedhen me votim të drejtpërdrejt dhe të fshehtë në njësinë zgjedhore sipas kritereve të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 25
Procedura për kandidim

1. Çdo anëtar i Odës gjëzon të drejtën që të kandidojë dhe të zgjedhet anëtar i Kuvendit të Odës, i cili është regjistruar, të ketë licencë valide dhe të jetë shtetas kosovar.
2. Anëtarët e KQZ-së dhe anëtarët e KNJZ-së nuk mund të janë kandidatë për anëtar të Kuvendit të Odës.
3. Anëtarët të cilët kanë ushtruar funksionin e anëtarit të Kuvendit të OSK-së për dy mandate nuk kanë të drejtë kandidimi në Kuvendin e OSK-së.
4. Që kandidatura të jetë e vlefshme, kandidati për anëtar të Kuvendit të Odës duhet të plotësojë edhe këto kriterë:
 - 4.1 Përbushja e detyrimeve të përcaktuara me nenin 11 të Statutit të Odës;
 - 4.2 Vendbanimi i përherershëm që korespondon me njësinë zgjedhore të rajonit përkatës apo në Institucionin ku ushtron kujdesin shëndetësor;
 - 4.3 Të mos jetë i sanksionuar nga Gjyqi i Nderit të OSK-së.
5. Kandidatura për anëtarë të Kuvendit të OSK-së duhet të mbështetet me nënshkrim nga së paku 5 anëtarë të OSK-së brenda njësisë përkatëse zgjedhore të kandidatit.
6. Mbledhja e nënshkrimeve bëhet në formularin e përcaktuar nga KQZ-ja.
7. Një anëtar i OSK-së mund të mbështes vetëm një kandidat për anëtar të Kuvendit të Odës.
8. Kandidati për anëtarë të Kuvendit nuk mund të jep nënshkrim mbështetës për kandidaturën e tij.
9. Afati dhe procedura e aplikimit të kandidaturës përcaktohet nga KQZ-ja.

Neni 26
Certifikimi i listës së kandidatëve

1. Pas përfundimit të procedurës së kandidimit, KQZ certifikon listën përfundimtare të kandidatëve sipas njësive zgjedhore dhe i publikon në afat prej 10 ditësh nga dita që ka përfunduar afati për dorëzimin e kandidaturave.
2. Nga dita e certifikimit të listës së kandidatëve, palët e pakënaqura lidhur me listën e

certifikuar të kandidatëve për Kuvendin e OSK-së, mund të paraqesin ankesën e tyre në afat prej 24 orëve nga ora e publikimit. Ankesa parashtronet pranë KQZ, i cili e shqyrton ankesën brenda 48 orëve nga ora që është pranuar ankesa.

3. Ndaj vendimit të KQZ-së me të cilën është shqyrtuar kërkesa, aplikuesi ka të drejtën e ankesës në Gjyqin e Nderit të OSK-së.
4. Pas shqyrtimit të ankesave në rast të paraqitjes, KQZ-ja certifikon listën përfundimtare të kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhjet për anëtarë të Kuvendi të OSK-së.
5. Në rast se në një Njësi Zgjedhore, numri i kandidatëve të certifikuar është i njëjtë me numrin e mandateve për atë Njësi Zgjedhore, atëherë konsiderohet që këta kandidatë kanë fituar mandatin zgjedhor me automatizëm.

PJESA IV **PROCESI ZGJEDHOR, QENDRA E VOTIMIT DHE DOKUMENTACIONI ZGJEDHOR**

KREU I **LISTA E VOTUESVE, FLETËVOTIMI DHE DISTRIBUIMI**

Neni 27 **Përbajtja e Listës së Votuesve**

1. Lista e Votuesve paraqet evidencë të anëtarëve të OSK-së me të drejtë vote, e që përmban këto të dhëna:
 - 1.1 Njësinë Zgjedhore në të cilën e realizon të drejtën e votës anëtar;
 - 1.2 Emrin dhe mbiemrin e anëtarit;
 - 1.3 Datën e lindjes;
 - 1.4 Numrin e licencës;
 - 1.5 Numrin e anëtarësisë;
 - 1.6 Numrin personal;
 - 1.7 Adresën e vendbanimit apo Institucionit ku ushtron kujdesin shëndetësor.
2. Lista e Votuesve e anëtarëve të OSK-së përpilohet sipas rendit alfabetik të emrave të tyre.
3. Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni do të përpunohen dhe menaxhohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 28 **Fletëvotimi**

1. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve të cilat shtypen dhe shpërndahen.
2. Fletëvotimi është me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha njësitë zgjedhore.
3. Numri i fletëvotimeve të shtypura nuk mund të jetë më shumë se 2% e anëtarëve

në listën përfundimtare të votuesve.

4. Fletëvotimi për zgjedhjet përgatitet nga KQZ-ja dhe duhet të përmbajë elemente sigurie sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së.
5. Fletëvotimi shtypet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të KQZ-së apo Sekretariatit të KQZ-së.
6. Fletëvotimi duhet të përmbajë:
 - 6.1 kodin e njësisë zgjedhore dhe qendrën e votimit;
 - 6.2 organin që do të zgjidhet;
 - 6.3 numrin rendor, emrin e mbiemrin e kandidatëve të renditur sipas rendit alfabetik të emrave të tyre.
7. KQZ-ja më tutje përcakton me anë të rregullës detajet e fletëvotimeve:
 - 7.1 përbajtjen, formatin dhe dukjen;
 - 7.2 mënyrën dhe kontrollin e printimit;
 - 7.3 verifikimin, shpërndarjen dhe trajtimin e fletëvotimit;
 - 7.4 veçoritë e sigurisë;
 - 7.5 çfarëdo çështje tjera të lidhura që nuk përcaktohen me këtë rregullore;
8. Në pjesën e pasme, fletëvotimi vuloset me vulën e KQZ-së.

Neni 29 **Përpilimi, procedimi dhe certifikimi i Listës së Votuesve**

1. Brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, Sekretariati i KQZ-së do të sigurojë listën e anëtarëve të OSK-së me të drejtë vote.
2. Lista e Votuesve do të përfshijë të gjithë anëtarët e OSK-së me të drejtë vote sipas kushteve lidhur me statusin e anëtarësise në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëvc Shëndetësor dhe nenit 8, paragrafit 2 të Statutit të OSK-së.
3. Sekretariati i KQZ-së do të kujdeset që Lista e Votuesve të jetë kategorizuar sipas Njësive Zgjedhore.
4. Sekretariati i KQZ-së pasi që ta ketë përgatitur Listën preliminare të Votuesve do t’ia procedojë për shqyrtim dhe miratim KQZ-së. KQZ-ja pas pranimit të Listës preliminare të Votuesve, atë do ta shpallë publikisht në web faqen zyrtare të OSK-së.
5. KQZ-ja do ta certifikojë Listën e Votuesve në afat prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas publikimit të Listës preliminare të Votuesve.
6. Të gjithë personat të cilët nuk janë përfshirë në Listën preliminare të Votuesve dhe konsiderojnë se me këtë u është cenuar e drejta e votës, kanë të drejtë që të paraqesin ankesë në afat prej dyzet e tetë (48) orëve nga publikimi i kësaj liste. KQZ-ja do të vendos për një ankesë të tillë në afat prej njëzet e katër (24) orëve nga ora e pranimit të ankesës.
7. Me aprovin e ankesës, KQZ-ja sipas detyrës zyrtare e ndryshon listën e Votuesve në përputhje me dispozitivin e vendimit me të cilin ka vendosur në mënyrë meritore për ankesën e parashtruar.

8. Vendimi i KQZ-së mund të atakohet në Gjyqin e Nderit të OSK-së.
9. Gjyqi i Nderit i OSK-së është organ përfundimtar në shkallë të dytë i cili vendos ndaj ankesave të parashtuara në afat prej dyzet e tetë (48) orëve.
10. Në bazë të vendimit të Gjyqit të Nderit të OSK-së ndaj ankesës së kandidatit, mund të ndryshon Lista përfundimtare e Votuesve.

Neni 30

Distribuimi dhe përdorimi i Listës së Votuesve

1. Pas certifikimit të Listës së Votuesve, KQZ-ja do të sigurojë për secilën KNJZ Listën e Votuesve për Njësinë përkatëse Zgjedhore. KNJZ-të do të disponojnë vetëm pjesën e Listës së Votuesve në të cilën përfshihen anëtarët me të drejtën e votës në njësinë përkatëse zgjedhore.
2. Listat e Votuesve për secilën Njësi Zgjedhore do t'i distribuohen KNJZ-ve përmes Sekretariatit të KQZ-së. Sekretariati i KQZ-së është i obliguar që Listat e Votuesve për Njësitë Zgjedhore t'ua dorëzojë në afat jo më të largët sesa (24) orë para hapjes së Qendrës së Votimit.
3. Nga momenti i dorëzimit të Listës së Votuesve për Njësinë Zgjedhore përkatëse, përgjegjësia për ruajtjen e saj është e kryesuesit të KNJZ-së.

KREU II

MENAXHIMI DHE VEPRIMET PËRGATITORE NË QENDRËN E VOTIMIT

Neni 31

Qendra e Votimit

1. Qendra e Votimit në të cilën organizohet procesi zgjedhor vendoset nëpër Njësitë Zgjedhore të përcaktuara me këtë rregullore.
2. KQZ-ja me vendim të veçantë mund të themelojë Qendër tjetër të Votimit në njësinë përkatëse zgjedhore, për të lehtësuar pjesëmarrjen sa më të madhe të votuesve për shkak të largësisë së Qendrës së Votimit.
3. KNJZ-të kanë për obligim që në koordinim me menaxhmentin e institucionit shëndetësor të përcaktojnë lokacionin e QV-së brenda hapësirës së institucionit gjegjës shëndetësor.
4. Mbështetur në rekomandimet e KNJZ, KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se 3 ditë para zgjedhjeve, publikon lokacionet e sakta të të gjitha QV-ve të njësive zgjedhore.
5. Në rast të ndonjë ndryshimi për shkaqe objektive, KNJZ-të mund ta ndërrojnë lokacionin e QV-ve të përcaktuar paraprakisht. Për ndryshimin e tillë KNJZ-të duhet ta njoftojnë

KQZ-në në kohë sa më të shpejtë para fillimit të procesit zgjedhor.

6. Secilit anëtar të regjistruar i caktohet QV-së që është lokacioni, ku emri i tij është i përfshirë në Listën Përfundimtare të Votuesve.
7. Nëse lokacioni i QV-së është ndryshuar, KQZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes formave elektronike.

Neni 32 **Dorëzimi dhe pranimi i materialit zgjedhor**

1. Kryesuesi i KNJZ-së është zyrtari i autorizuar që të bëjë pranimin dhe dorëzimin e materialit zgjedhor nga dhe te KQZ-ja.
2. Me rastin e pranimit të materialit zgjedhor, kryesuesi i KNJZ-së do të nënshkruajë një procesverbal të veçantë që është miratuar nga KQZ-ja dhe i cili mban evidencën me të dhënrat siç janë:
 - 2.1 Listën e Votuesve të Njësisë përkatëse Zgjedhore;
 - 2.2 Numrin e përcaktuar të fletëvotimeve për Njësinë Zgjedhore;
 - 2.3 Librin e Votimit;
 - 2.4 Prosesverbalin për pranimin e materialit zgjedhor;
 - 2.5 Prosesverbali i KNJZ-së mbi procesin zgjedhor;
 - 2.6 Kutinë për votim me numrin e bashkëngjitur të QV-së;
 - 2.7 Thesin për ambalazhimin e materialit zgjedhor.
3. Kryesuesi i KNJZ-së duhet ta marrë një kopje të procesverbalit nga paragrafi 2 i këtij nenit mbi pranimin e materialit zgjedhor nga KQZ-ja. Kopja e procesverbalit do të ri-nënshkruhet nga kryesuesi i KNJZ-së dhe personi i autorizuar nga Sekretariati i KQZ-së.
4. Në ditën e zgjedhjeve, Kryesuesi i KNJZ-së, i dërgon materialet për mbajtjen e zgjedhjeve në qendrën e votimit.

Neni 33 **Përgatitja e Qendrës së Votimit**

1. Të gjithë anëtarët e KNJZ-së duhet të jenë të pranishëm në QV, së paku një orë para fillimit të votimit.
2. Komisionerët e KNJZ-ve janë përgjegjës për përgatitjen teknike të QV-ve nëpër Njësitë Zgjedhore.
3. Komisionerët do të rregullojnë në atë mënyrë QV-it ashtu që do të rendisin tavolinën në ballë të hyrjes së QV-it ku do të qëndrojë komisioneri për Listë të Votuesve, ndërkaq kutia e votimit do të vendoset në mesin e hapësirës së QV-it.
4. Komisionerët janë të obliguar që të përgatisin vendin e veçantë ku votuesi do të votojë në mënyrë që të ruhet fshehtësia e votës së tij. Tavolina e votimit duhet të vendoset në atë mënyrë që votuesi ta ketë shpinën e kthyer nga komisionerët dhe vëzhguesit e pranishëm. KNJZ-te mund të caktojnë më tepër se një tavolinë të

votimit, por jo më tepër se tri (3) tavolina për QV-it.

5. Rregullimi teknik dhe fizik në QV-it nuk do të ndryshohet deri në përfundimin e procesit të votimit, respektivisht deri në mbylljen e tij.

Neni 34 **Hapja dhe mbyllja e Qendrës së Votimit**

1. KNJZ-të janë të obliguara që të hapin QV-it në orën 08:00 të ditës së caktuar përmajtjen e zgjedhjeve.
2. Nëse QV-it hapet me vonesë, Kryesuesi i KNJZ-së e informon menjëherë Sekretariatin e KQZ-së dhe regjistron kohën e hapjes në Librin e QV-it.
3. QV-it të hapura sipas paragrafit 1 të këtij neni do të mbyllen në orën 16:00 të së njëjtës ditë kur mbahet votimi. Pas mbylljes së QV-it askush nuk do të lejohet të votojë. QV-it do të konsiderohet e mbyllur me votimin e votuesit të fundit i cili është i pranishëm pranë QV-it në kohën e mbylljes.
4. KNJZ-të mund të mbyllin QV-it para kohës së përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni po që se kanë votuar të gjithë anëtarët me të drejtë vote nga Lista e Votuesve.
5. Komisionerët duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së mbajtjes së procesit zgjedhor, ku të paktën duhen të jenë të pranishëm dy nga tre komisionerët e KNJZ-ve, kur për lëshimin e QV-it është natyra e nevojave personale. Mungesa e cilitdo nga komisionerët nuk mund të jetë në kohëzgjatje më tepër se tridhjetë (30) minuta.
6. Anëtarët e KNJZ-ve dhe Kryesuesi votojnë të parët kur hapet QV-it.

KREU III **MENAXHIMI I PROCESIT TË VOTIMIT**

Neni 35 **Procesi i votimit**

1. Votimi është personal dhe bëhet në fletëvotim, duke shenjuar emrin e kandidatit që zgjedhet në Kuvendin e Odës.
2. Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm për një (1) kandidat.
3. Votuesi me të hyrë në QV-it është i obliguar që ta dëshmojë identitetin e tij përmes identifikimin e të drejtës së tij përvotim, me njëren nga dokumentet në vijim:
 - 3.1 letërnjoftimi i vlefshëm;
 - 3.2 ID – Kartela e OSK-së;
 - 3.3 pasaporta valide;
 - 3.4 leja e vozitjes e vlefshëm.

4. Komisioneri i Listës së Votuesit pasi që ta ketë vërtetuar identitetin e tij dhe ka gjetur emrin e tij në Listën e Votuesit, duhet që të kërkojë nga votuesi që të nënshkruhet në rubrikën e Listës së Votuesve në hapësirën e dedikuar për nënshhkrim për votuesin e identifikuar në Listën e Votuesve.
5. Pas nënshkrimit në Listën e Votuesve, komisioneri kontrollor do t'ia dorëzojë votuesit fletëvotimin e palosur dyfish, duke u përrmbajtur nga çfarëdo udhëzimi që favorizon për votim cilindro nga kandidatët. Komisioneri kontrollor mund të njoftojë votuesin vetëm për rregullsinë e mënyrës së votimit që i përket të drejtës që në fletëvotim votuesi të shënojë vetëm njërin nga kandidatët e listuar në fletëvotim.
6. Votuesi pasi që ta pranojë fletëvotimin do të drejtohet në tavolinën e votimit. Pasi që votuesi ta ketë përfunduar votimin, fletëvotimin e tij ai duhet ta vendosë në kutinë e votimit. Komisioneri kontrollor është i obliguar që të verifikojë futjen e fletëvotimit në mënyrë që në fletëvotimin e palosur të shihet vula zyrtare e KQZ së.
7. Votimi në zgjedhjet e njëjta më shumë se një herë përbën vepër penale dhe është i dënueshëm në përputhje me kodin e etikës nga kjo rregullore si dhe Kodin Penal të Kosovës.

Neni 36

Rendi dhe rregulli në Qendrën e Votimit

1. Kryesuesi i Qendrës së votimit do të kujdeset që në QV të sigurohet rendi dhe rregulli në kuptim të respektimit të procedurave dhe përbajtjes të pjesëmarrësve në proces zgjedhor nga veprimet e ndaluara të përcaktuara nga KQZ-ja.
2. Kryesuesi është i obliguar që mos të lejon hyrjen dhe qëndrimin e personave në QV, përfshirë edhe votuesit pasi ta kenë përfunduar votimin. Votuesit do të futen në QV deri në atë numër sa nuk cenohet rendi në QV-it.
3. Komisionerët, vëzhguesit dhe cilido nga votuesit e pranishëm nuk lejohet që të ndikojnë në çfarëdo mënyre tek votuesit për të votuar ndonjërin nga kandidatët.
4. Në rast se ndonjëri nga të pranishmit nuk respekton rregullin nga paragrafi 3 i këtij neni, kryesuesi i QV-it ka drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen. Në rast se veprimi i tillë përsëritet nga personi i njëjtë kryesuesi ka të drejtë të kërkojë largimin e tij nga QV-it. Kryesuesi është i obliguar që në çdo rast kur refuzon personi i tillë që të veprojë sipas kërkësave të tij, të lajmërojë organet e rendit.
5. Kur veprimet ndërmerrin nga ndonjëri nga komisionerët, kryesuesi do të veprojë në të njëjtën mënyrë sikurse në paragrafin paraprak. Në rast të largimit nga QV-it të komisionerit, procesi i votimit do të vazhdojë. Procesi i votimit do të ndalohet në rast se në QV-it nga tre (3) komisionerë mbetet vetëm kryesuesi, atëherë ai do të kontaktojë me Sekretariatin e KQZ-së dhe me vendim të KQZ-së do të autorizohet një person që të përbush kushtin minimal të pranisë prej së paku dy komisionerëve, përfshirë kryesuesin e QV-it.
6. Në çdo rast kur vie deri te cenimi i rendit dhe rregullit në QV-it, vërejtjet e tillë dhe veprimet sipas këtij neni do të shënohen në Librin e Votimit.

Neni 37
Libri i Votimit

1. Libri i Votimit është formë e përcaktuar nga KQZ-ja në të cilën shënohen vërejtjet dhe ngjarjet e rëndësishme që ndërlidhen me procesin zgjedhor në QV përkatës gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Libri i Votimit mirëmbahet dhe ruhet ekskluzivisht nga kryesuesi i QV.
3. Në Librin e Votimit të drejtën për të shënuar vërejtjet kanë komisionerët dhe vëzhguesit e akredituar. Në çdo rast kur votuesi paraqet vërejtjet lidhur me procesin e votimit, kryesuesi është i obliguar që ta shënojë deklaratën e tij dhe pasi që t'ia lexojë deklaratën e shënuar e nënshkruan së bashku me votuesin i cili ka paraqitur vërejtjen.
4. Libri i Votimit është material zgjedhor dhe si i tillë duhet të dorëzohet në KQZ, së bashku me materialin tjetër përcjellës zgjedhor.

Neni 38
Votimi me kusht

1. Në rast se votuesi nuk mund të gjejë emrin dhe mbiemrin e tij në Listën e Votuesve, ndërkaq dëshmon me dokument identifikues dhe me licencë për ushtrimin e profesionit dhe në kuptim të rregullimit të brendshëm të OSK-së, plotëson kushtet për realizim të drejtës së votës, atij i lejohet votimi me kusht.
2. Pasi që vërtetohet fakti sipas paragrafit I, votuesit me kusht do t'i merren të dhënat personale duke përfshirë edhe numrin e licencës të cilat shënohen në rubrikë të veçantë në Listën e Votuesve të dedikuar për votim me kusht.
3. Pasi që komisioneri kontrollor i'a jepë fletëvotimin për votim dhe votuesi të ketë votuar, fletëvotimi i palosur do të futet në zarf i cili do të ruhet nga kryesuesi i QV-it. Votat me kusht dorëzohen në KQZ duke mos i përfshirë në votat e numëruara në kuti.
4. Numrimi i votave me kusht ekskluzivisht bëhet nga KQZ-ja.

KREU IV
PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 39
Numërimi i votave

1. Pas mbylljes së QV, kryesuesi i QV i njofton vëzhguesit që mos ta lëshojnë QV deri në përfundimin e procesit të numërimit të votave. Në rast se ndonjëri nga ta e lëshon QV-it, kryesuesi i njofton se nuk do të lejojë hyrjen e sërishtme të tyre në QV.
2. Procesi i numërimit fillon me numërimin e votuesve të nënshkruar në Listën e Votuesve dhe numrin e tillë e evidentojnë për shënim në procesverbal.

3. Më pas numérohen fletëvotimet e papërdorura dhe poashtu ky numër evidentohet dhe shënohet në procesverbal.
4. Me hapjen e kutisë së votimit fillon diferencimi i fletëvotimeve të dëmtuara duke shënuar numrin e tyre.
5. Pas ndarjes së fletëvotimeve të dëmtuara, procesi i numërimit fillon me identifikimin e fletëvotimeve të pavlefshme, që konsiderohen kur:
 - 5.1 në fletëvotim janë shënuar më tepër se një kandidat;
 - 5.2 kur nuk është i qartë votimi i votuesit;
 - 5.3 kur në fletëvotim janë shënuar përbajtje jorelevante;
 - 5.4 kur fletëvotimi është i zbrazët.
6. Pas ndarjes së votave të pavlefshme, fillon numërimi një nga një votë duke mbajtur evidencën për secilën votë të numëruar.
7. Numërimi do të bëhet në atë mënyrë ku njëri nga komisionerët do të caktohet nga kryesuesi për të paraqitur secilin fletëvotim duke e ngritur atë në pozitë të dukshme për të gjithë të pranishmit. Kryesuesi dhe komisioneri tjetër do të mbajnë paralelisht evidencat që në fund të bëhet krahasimi i saktësisë së numërimit.
8. Pas përfundimit të numërimit dhe krahasimit të të dhënave të mbajtura nga kryesuesi dhe njëri nga komisionerët, rezultati i tillë shënohet në procesverbalin e QV-it dhe atë të KNJZ-së.
9. Nëse evidenca e mbajtur nga kryesuesi dhe njëri kornisioner nuk përpushton, atëherë do të përsëritet numërimi deri në konstatimin e plotë të dyanshëm nga kryesuesi dhe komisioneri.

Neni 40 **Përmbyllja e procesit të numërimit**

1. Pas numërimit të votave dhe përmbylljes së procesverbalit i cili nënshkruhet nga kryesuesi dhe komisionerët e KNJZ së, fletëvotimet e vlefshme futen në zarf të veçantë dhe ndahen nga fletëvotimet e dëmtuara dhe ato të pavlefshme. Fletëvotimet e dëmtuara dhe të pavlefshme futen në një zarf të veçantë.
2. Fletëvotimet me kusht që janë të futura në zarf po ashtu futen në një thes të veçantë.
3. Materiali nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij nenit futen në kstinë e votimit së bashku me procesverbalet përcjellëse. Kutia e votimit e mbyllur dorëzohet në Sekretariatin e KQZ-së nga ana e kryesuesit pasi të ketë përfunduar procesi i numërimit dhe ambalazhimit të materialit zgjedhor për dorëzim.
4. KQZ-ja pas pranirnit të materialit zgjedhor nga Sekretariati i KQZ-së, do të fillojë procesin e verifikimit dhe përmbledhjes së rezultateve nga KNJZ-të.
5. Materiali zgjedhor duhet t'i dorëzohet Sekretariatit të KQZ-së jo më vonë se ora 20:00 e ditës së zgjedhjeve.

KREU V
CERTIFIKIMI DHE SHPALLJA E REZULTATIT ZGJEDHOR

Neni 41
Konstatimi dhe shpallja e rezultatit

1. Pasi t e jen  mbledhur t e dh nat nga procesverbalet e KNJZ-ve, KQZ-ja konstaton kandidat t q  kan  fituar m  s  shumti vota n  kuad r t  Nj sis  p rkat se Zgjedhore. KQZ-ja konstaton se kandidat t q  kan  marr  m  s  shumti vota, kan  fituar mandatin zgjedhor.
2. N  rast se dy apo m  shum  kandidat kan  vota t  barabarta p r fitimin e mandatit, n  brani t  KQZ-s  dhe kandidat ve q  kan  vota t  barabarta, hidhet shorti sipas t  cilit konstatohet fituesi i mandatit.
3. KQZ-ja pasi ta ket  p rfunduar procesin e evidentimit t  mandateve krijon list n preliminare t  kandidat ve q  kan  fituar mandatin dhe publikon rezultatin preliminar n  web faqen zyrtare t  OSK-s .

Neni 42
Ankimimi n  rezultatin zgjedhor

Pal t e pak naqura me rezultatin e publikuar mund t  paraqesin ankes n n  KQZ n  afat prej 24 or ve nga ora e publikimit t  rezultatit preliminar. KQZ-ja do t  shqyrtoj  ankes n n  afat prej 48 or ve nga ora e pranimit t  ankes s. Parashtimi i ankes s e pezullon procesin e certifikimit t  rezultatit p rfundimtar deri n  nxjerrjen e vendimit p rfundimtar t  KQZ s .

Neni 43
P rfundimi i procesit zgjedhor

1. KQZ-ja e certifikon rezultatin zgjedhor jo m  shum  se pes  (5) dit  nga dita e zgjedhjeve, por jo m  pak se 24 or  pas mbylljes s  QV-it. Certifikimi i rezultatit zgjedhor miratohet me aprovin e KQZ-s .
2. Procesi zgjedhor p r Kuvendin e OSK-s  konsiderohet i p rfunduar me shpalljen e rezultateve p rfundimtare nga KQZ-ja.

Neni 44
Nd rprerja e parakohshme e mandatit t  an tarit t  Kuvendit

1. Mandati i an tarit t  Kuvendit t  Od s p rfundon para p rfundimit t  mandatit p r t  cilin esht  zgjedhur n  rast t :
 - 1.1 humbjes s  statusit t  an tarit t  Od s, n  dit n e humbjes s  statusit;
 - 1.2 dor heqjes, n  dit n e paraqit s s  dor heqjes me shkrim;
 - 1.3 revokim.

2. Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohet përshtatshmërisht në organet e tjera të Odës, nëse me dispozitat e kësaj rregullore nuk përcaktohet ndryshe.
3. Mandati i anëtarit të Kuvendit të Odës revokohet nëse:
 - 3.1 merr pjesë në marrjen e vendimeve të kundërligjshme, gjegjësisht vendimeve apo veprimeve që dëmtojnë Odën;
 - 3.2 i është marrë përkohësisht ose përgjithmonë leja për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur (licenca);
 - 3.3 me vendim gjykate të formës së prerë, i është marrë, gjegjësisht kufizuar aftësia e veprimtarisë;
 - 3.4 është dënuar me vendim të formës së prerë me burgim të pakushtëzuar mbi 1 vit për vepra në fushën e veprimtarisë shëndetësore/stomatologjike.
 - 3.5 nuk merr pjesë së paku në tri (3) mbledhje radhazi, të Kuvendit të OSK-së, pa arsyе.
4. Propozimin për revokimin e mandatit të anëtarit të Kuvendit e paraqet Kryetari OSK-së.
5. Në rast kur ndaj një anëtarit të organeve të OSK-së, fillon procedura etike pranë organeve kompetente të OSK-së, apo procedurë gjyqësore për keqpërdorim të detyrës profesionale, Kryetari OSK-së, menjëherë e propozon pezullimin e mandatit të anëtarit, nga detyra, deri në vendosje meritore të organeve kompetente.
6. Pezullimi nga detyra, nuk paragjykon fajësinë e anëtarit në fjalë.
7. Kryetari i OSK-së njofton KQZ se anëtarit të Kuvendit i ka pushuar mandati dhe kërkon nga KQZ-ja të bëjë përzgjedhjen e anëtarit sipas radhës së renditjes së listës së kandidatëve nga njësia zgjedhore përkatëse.

Neni 45 **Zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit të OSK-së**

1. Në rast se për cilëndo rrethanë të paraparë me dispozitat e Rregulloes për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OSK-së, anëtarit të Kuvendit i ka pushuar mandati para kohës së skadimit të mandatit të Kuvendit të OSK-së, zëvendësimi i të njëjtit do të bëhet nga KQZ-ja.
2. Zëvendësimi do të bëhet me njoftimin formal nga Kryetari i OSK-së si kryesues i Kuvendit të OSK-së.
3. Zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit, të cilit i ka pushuar mandati para kohe, bëhet jo më vonë se pesëmbedhjetë (15) ditë nga dita e njoftimit formal nga Kryetari i OSK-së, duke e konstatuar zëvendësimin e tillë me kandidatin e të njëjtës njësi zgjedhore me numër të votave që është renditur pas anëtarit të cilit i ka pushuar mandati. Mandati i anëtarit të ri të Kuvendit zgjat deri në skadimin e mandatit të zgjedhur (ekzistues) të anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e rregullta.
4. Në rastet kur në njësinë zgjedhore nuk ka kandidat i cili e pason me vota anëtarin e Kuvendit i cili duhet të zëvendësohet, KQZ-ja i shpallë zgjedhjet në atë njësi zgjedhore, duke i përgjysmuar afatet e parapara me këtë rregullore sa i përket procedurave zgjedhore të parapara me këtë rregullore.

5. Të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme përshtatshmërisht me rastin e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit lidhur me organizimin e procesit zgjedhor në mënyrë të veçantë në njësitë përkatëse zgjedhore.

PJESA V

PROCEDURAT E ZGJEDHJES SË ORGANeve TË OSK-SË

KREU I ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZËVENDËS KRYETARIT TË OSK-SË

Neni 46 Zgjedhja e Kryetarit

1. KQZ shpall zgjedhjet për Kryetar të OSK, më së voni 5 (pesë) ditë pas ditës së certifikimit të rezultatit zgjedhor.
2. Formulari për aplikim për kandidat për Kryetar të OSK-së me dokumentacionin përkatës mbi plotësimin e kritereve, dorëzohen në KQZ, për certifikim, jo më larg se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së zgjedhjeve për Kryetar të OSK-së.
3. Çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të jap nënshkrimin vetëm për një kandidaturë.
4. Secili kandidat për Kryetar të njëjtën ditë duhet të paraqesë programin para anëtarëve të Kuvendit.
5. KQZ është organ kompetent për vlerësimin e përbushjes së kritereve të kandidimit.

Neni 47 Kriteret e kandidimit

1. Kandidati për kryetar të OSK-së duhet të jetë anëtar i Kuvendit dhe të përbushë këto kritere:
 - 1.1 Të jetë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
 - 1.2 të ketë jo më pak se 10 vjet përvjohë në profesion;
 - 1.3 të ketë përvjohë në udhëheqje së paku 3 vite;
 - 1.4 të mos jenë marrë masa ndëshkimore etike ndaj tij;
 - 1.5 të ketë integritet dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;
 - 1.6 të ketë të publikuara punime shkencore/ profesionale;
2. Secila kandidaturë për Kryetar të OSK duhet të mbështetet me nënshkrimet e 10 anëtarëve të Kuvendit të OSK-së. Kandidati nuk mund të jep nënshkrim mbështetës për vetveten.

Neni 48
Votimi pér Kryetar

1. Kuorumi pér zgjedhjen e Kryetarit tē OSK éshtë me shumicën e thjeshtë tē anëtarëve tē Kuvendit tē OSK së.
2. Votimi pér Kryetar tē OSK-së bëhet me votë tē fshehtë.
3. Konsiderohet se éshtë zgjedhur kandidati i cili ka fituar më së shumti vota, me kusht që pér kryetar, tē votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve tē Kuvendit.
4. Në rast se asnjëri kandidat nuk ka fituar shumicën e votave tē anëtarëve tē Kuvendit, dy kandidatë me numrin me tē madh tē votave do tē kualifikohen pér raundin e dytë tē votimit.
5. Në raundin e dytë tē votimit konsiderohet se éshtë zgjedhur kandidati që ka fituar më shumë vota nga anëtarët e kuvendit.
6. Në rast se dy kandidatë tē radhitur si tē parët kanë numër tē barabartë tē votave, organizohet raundi i ri i votimit derisa tē arrihet kriteri nga paragrafi paragrafi 5 i këtij nenit.
7. Me përfundimin e procesit zgjedhor, KQZ shpall rezultatin e zgjedhjes së Kryetarit tē Odës dhe me këtë rast përpilon dhe miraton procesverbalin e veçantë në tē cilin evidentohen hollësitë e procesit zgjedhor.
8. Mandati i Kryetarit zgjat katër (4) vjet, me mundësi rizgjedhjeje pér një mandat tjetër.

Neni 49
Përfundimi i parakohshëm i mandatit tē Kryetarit

1. Kryetarit tē OSK-së i përfundon mandati përpara kohe në këto raste:
 - 1.1 kur merret vendim nga Kuvendi me votat e jo më pak se dy tē tretave tē anëtarëve;
 - 1.2 kur jep dorëheqje;
 - 1.3 kur humb zotësinë e plotë pér tē vepruar;
 - 1.4 kur bëhet i paaftë, pér arsy shëndeti.

Neni 50
Zgjedhja e Zv.kryetarëve tē OSK-së

Me propozim tē Kryetarit tē OSK-së, Kuvendi me shumicë votash tē anëtarëve prezent zgjedh zv.Kryetarët në një votim tē hapur, në bazë tē nenit 25, paragrafi 2 dhe 3 tē Statutit tē OSK-së.

KREU II
ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 51

1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të OSK-së bëhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjes së Kryetarit të OSK-së.
2. Kryetari dhe dy (2) zv.kryetarët e OSK-së janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare, ndërsa pesë (5) anëtarët tjerë zgjidhen nga Kuvendi i OSK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Tre (3) anëtarë të Këshillit Drejtues propozohen nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të mbështetet nga së paku 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidat për Këshill Drejtues.
5. Kandidatura për Këshill Drejtues së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
6. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen anëtarë të Këshillit Drejtues.

KREU III
ZGJEDHJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ODËS

Neni 52

1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bëhet jo më vonë se 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OSK-së.
2. Kyetari, zëvendës kryetari dhe katër (4) anëtarë zgjedhen nga Kuvendi i OSK- -së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Dy (2) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës propozohen nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës duhet të mbështet nga së paku pesë (5) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit. Një anëtar i kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidat për Këshill Mbikëqyrës.
5. Kandidatura për Këshillin Mbikëqyrës së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
6. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

KREU IV **ZGJEDHJA E KËSHILLIT ETIK**

Neni 53

1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Etik bëhet jo më vonë se 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit te OSK-së.
2. Kryetari, zëvendës kryetari dhe 2 (dy) anëtarët tjerë zgjidhen nga Kuvendi i OSK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Një (1) anëtar i Këshillit Etik propozohet nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Kandidatura për anëtar të Këshillit Etik duhet të mbështetet nga së paku pesë (5) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidat për Këshill Etik.
5. Kandidatura për Këshill Etik së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
6. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen anëtarë të Këshillit Etik.

KREU V **ZGJEDHJA E GJYQIT TË NDERIT**

Neni 54

1. Zgjedhja e anëtarëve të Gjyqit të Nderit bëhet jo më vonë se 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OSK-së.
2. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 2 (dy) anëtarët tjerë zgjidhen nga Kuvendi i OSK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Një (1) anëtar i Gjyqit të Nderit propozohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
4. Kandidimi për kryetar të Gjyqit të Nderit duhet të mbështetet nga dhjetë (10) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës, ndërsa për zv.kryetarin dhe dy anëtarët tjerë nga 5 nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës.
5. Kandidatura për Gjyqin e Nderit së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
6. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen anëtarë të Gjyqit të Nderit.

KREU VI **ZGJEDHJA E PROKURORIT TË ODËS**

Neni 55

1. Zgjedhja e Prokurorit të Odës bëhet jo më vonë se 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OSK-së.
2. Prokurori dhe Zv.Prokurori zgjidhen nga Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të Odës, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për Prokuror të Odës duhet të mbështetet nga së paku dhjetë (10) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të Odës, ndërsa për Zv.Prokurorin nga së paku pesë (5) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit.

4. Kandidatura për Prokuror dhe Zv.Prokuror të Odës së bashku me nënshkrimet dorëzohet në KQZ.
5. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen për Prokuror dhe Zv.Prokuror të Odës.

KREU VII
KOMISIONET E PËRHERSHME DHE PËRKOHSHME
TË ODËS

Neni 56

1. Komisionet e Përhershme të Odës janë:
 - 1.1 komisioni për çështje etike;
 - 1.2 komisioni për licencim;
 - 1.3 komisioni për edukim specialistik;
 - 1.4 komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
 - 1.5 komisioni për buxhet dhe financa;
 - 1.6. komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Neni 57
Zgjedhja e Komisioneve të përhershme

1. Komisionet nga neni paraprak kanë nga shtatë (7) anëtarë nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryeuesi dhe Zv.kryesuesi i komisionit.
2. Anëtarët e komisioneve të përhershme të Odës propozohen nga Këshilli Drejtues dhe propozimi i tillë aprovohet në Kuvendin e Odës me votim të hapur.
3. Propozimet nga paragrafi 2 miratohen me shumicën e votave të anëtarëve prezentë të Kuvendit.
4. Fushëveprimi i Komisioneve te perhershme përcaktohet me akte të veçanta normative të miratuar nga Kuvendi i Odës.

Neni 58
Zgjedhja e Komisioneve të përkohshme

1. Me propozimin e Këshillit Drejtues, Kuvendi i Odës mund të themelojë Komisione të përkohshme.
2. Komisionet e përkohshme zgjidhen në kohë të caktuar dhe për çështje specifike për të cilat konsiderohet se nevojitet trajtim i ndarë dhe jashtë fushëveprimit të komisioneve të përhershme.
3. Fusheveprimi i Komisioneve te përkohshme përcaktohet me akte të veçanta normative të miratuar nga Kuvendi i Odës.
4. Miratimi i propozimit për themelim të Komisioneve të përkohshme bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse ai i Komisioneve të përhershme.

PJESA VI

VËZHGMIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

KREU I

PROCEDURAT PËR VËZHGMIM, AKREDITIMI DHE AUTORIZIMET E VËSHGUESVE

Neni 59

Propozimi i vëzhguesve

1. Secili kandidat i cili merr pjesë në procesin zgjedhor ka të drejtë që të propozojë një person në cilësi të vëzhguesit në Njësinë Zgjedhore në të cilën është certifikuar kandidatura e tij.
2. Kandidati mund ta propozojë vëzhguesin vetëm brenda Njësisë Zgjedhore në të cilin zgjidhet. Vëzhguesi nuk mund të jetë kandidat për anëtar të Kuvendit.
3. Për të propozuar vëzhguesin, kandidati duhet që të parashtrojë kërkesë në KQZ së bashku me formularin për kandidim dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
4. Formulari i kërkesës nga paragrafi 3 përcaktohet nga KQZ.

Neni 60

Kërkesat e organizatave për akreditim

1. Organizatat joqeveritare që shprehin interes për të përcjellë procesin zgjedhor në OSK, kanë të drejtë që të parashtronë kërkesën për akreditim nga dita kur zgjedhjet për Kuvendin e OSK-së të jenë shpallur nga KQZ-ja.
2. Kërkesat nga paragrafi 1 duhet parashtruar pranë KQZ-së jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
3. Organizatat joqeveritare që e parashtronë kërkesën për akreditim kanë të drejtë që të propozojnë nga një përfaqësues në cilësi të vëzhguesit, për një QV.
4. Formulari i kërkesës nga paragrafi 2 përcaktohet nga KQZ.

Neni 61

Akreditimi i vëzhguesve dhe organizatave

1. KQZ-ja do të akreditojë organizatat joqeveritare dhe vëzhguesit e kandidatëve jo më vonë se dhjetë (10) dita nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Me rastin e akreditimit të vëzhguesit dhe organizatave joqeveritare, KQZ-ja do ta nxjerrë listën e vëzhguesve dhe organizatave të akredituara për secilën QV. Lista do t'i dërgohet KNJZ-ve.
3. Në listën nga paragrafi 2, KQZ-ja do të shënojë të dhënat e secilit përfaqësues të një organizate që ka parashtruar kërkesën për akreditim, duke specifikuar QV-në për të cilën është akredituar përfaqësuesi.
4. Në qoftë se kërkesat e kandidatëve apo të organizatave joqeveritare nuk përmblushin

- kushtet që janë të cekura në formularët e kërkesave dhe kushteve të përcaktuara me këtë rregullore, KQZ-ja do të refuzojë akreditimin.
5. Palët e interesuara kanë të drejtë të parashtronë ankesë pranë KQZ-së në një afat prej dyzetë e tetë (48) orëve nga ora e publikimit të listës së subjekteve të akredituara dhe atyre që u janë refuzuar kërkesat për akreditim.
 6. Për ankesat nga paragrafi 5, KQZ-ja do të vendosë në një afat prej dyzetetë (48) orëve nga përfundimi i afatit për parashtrim të ankesave.

Neni 62 Të drejtat e vëzhguesve të akredituar

1. Vëzhguesit e akredituar, duke përfshirë vëzhguesit e propozuar nga kandidatët apo përfaqësuesit e organizatave të akredituara, nga ora kur hapet QV-it e deri në përfundimin e numërimit të votave pranë KNJZ-ve kanë këto të drejta:
 - 1.1 të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës nga hapja dhe mbyllja e vendvotimit e deri në përfundimin e numërimit të votave në KNJZ;
 - 1.2 të vëzhgojnë çdo veprim të komisionerëve dhe të vrojtojnë mënyrën e punës në QV;
 - 1.3 të vëzhgojë mënyrën e identifikimit të votuesve nga Lista e Votuesve;
 - 1.4 të mbajnë shënimë lidhur me ecurinë e procesit në QV;
 - 1.5 të jenë të pranishëm në rastin e plotësimit të procesverbalit të QV;
 - 1.6 të paraqesin vërejtjet e tyre në Librin e Votuesve.
2. Në rast se vëshguesi i kandidatit nuk ka shënuar vërejtjen e tij në Librin e Votuesve, kandidati në ankesën e tij nuk mund ta bazojë pretendimin në dëshmitë e vëzhguesit i cili ka qenë i akredituar sipas propozimit të tij.

Neni 63 Obligimet e vëzhguesve

1. Vëzhguesit dhe përfaqësuesit e akredituar gjatë procesit zgjedhor nuk kanë të drejtë të realizojnë çfarëdo komunikimi me votuesit.
2. Vëzhguesit nuk duhet të ndërmarrin asnjë veprim përmes së cilit do të ndikonin në vullnetin e lirë të votuesve.
3. Gjatë qëndrimit në QV vëshguesi obligohet të jetë i pajisur me mjet identifikues të lëshuar nga KQZ-ja.
4. Në çdo rast kur cilido komisioner vëren që vëzhguesi nuk i përbahet rregullave të procesit zgjedhor, vërejtjen e tillë do ta shënojë në Librin e Votuesve dhe për këtë do ta njoftojë kryesuesin e QV-së. Kryesuesi i QV-së duhet t'ia tërheq vërejtjen vëzhguesit për sjelljet e tillë dhe në rast të përsëritjes ai duhet të kërkojë largimin e vëzhguesit nga QV.

Neni 64

Ankesat nga vëzhguesit dhe organizatat e akredituara

1. Vëzhguesi dhe organizatat e akredituara kanë të drejë që të parashtronë ankesë lidhur me parregullsitë që i evidentojnë në QV-në e KNJZ-së.
2. Ankesa nga paragrafi 1 i parashtrorhet KQZ-së në një afat prej njëzet e katër (24) orëve nga mbyllja e QV-së. KQZ-ja vendosë për ankesën e parashtruar në afat prej njëzet e katër (24) orëve nga ora e parashtrimit të ankesës.

PJESA VII

DISPOZITAT NDËSHKUESE, PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

KREU I DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 65

1. Anëtarët e KQZ-së, KNJZ-së, Sekretariatit dhe personat tjera në shërbim të procesit zgjedhor, mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative për procesin zgjedhor.
2. Ndaj anëtarëve të OSK-së dhe kandidatëve për anëtarë të organeve të OSK-së të cilat cenojnë procesin zgjedhor për organe të OSK-së ose nuk respektojnë parimet e përcaktuara me këtë rregullore, shkeljet e tilla do të shërbejnë si bazë për iniciimin e procedurës etike për shkelje të rëndë të detyrimeve.
3. Procedura e vërtetimit të shkeljes së pretenduar zbatohet përshtatshmërisht me dispozitat e rregullores për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes etike dhe profesionale të OSK-së.
4. Ndaj rasteve nga paragrafi 1 dhe 2, mund të shqiptohet në mënyrë të drejtpërdrejtë njëra nga masat e parapara, në pajtim me paragrafin 1 me nënparagrafin 6, ose masa në nënparagrafin 7, të nenit 25 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë 04/L- 150, varësisht nga rrethanat e shkeljes.
5. Shkelja etike nuk konsumon veprën penale.
6. Gjobat, nga paragrafi 1, vihen nga Gjyqi i Nderit i OSK-së.

KREU II DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 66

Dispozitat që rregullojnë procesin zgjedhor të Njësisë Zgjedhore dhe KNJZ-së, zbatohen përshtatshmërisht edhe për Qendrat e Votimit dhe KQV-në.

Neni 67

1. Asnjë procesverbal i KQZ-së, KNJZ-së ose i një komisioni tjetër zgjedhor, nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.
2. Fletëvotimet dhe materialet tjera zgjedhore ruhen në ambientet e Odës deri në përfundim të mandatit.
3. Të gjitha fletëvotimet asgjësohen sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 68 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i OSK-së.

Neni 69 Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen dispozitat e rregullores për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, mënyrën e zgjedhjes dhe revokimin e anëtarëve të organeve të Odës së Stomatologëve të Kosovës me nr. Prot. 550 të datës 09.11.2018.
2. Çështjet të cilat nuk janë të parapara me këtë rregullore dhe legjislacionin e OSK-së, rregullohen nga KQZ në përputhje me standartet, kërkesat dhe praktikat pozitive dhe praktikat e mira të procesit zgjedhor.

Prishtinë, 12.11.2022

Kryetari i OSK-së
Prof.Dr. Blerim Kamberri



